



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 104

Tiranë – E mërkurë, 30 qershor 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 13116, datë 23.6.2021	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 9779
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 30.6.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 389, datë 12.6.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit”, të ndryshuar..... 9779
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 141, datë 15.6.2021	Mbi miratimin e rregullores, për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, në sektorin e energjisë elektrike..... 9779
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Bledar Sulkja..... 9788

**DEKRET****Nr. 13116, datë 23.6.2021****PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe të nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 20 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Anila Islam Koni (Pula)
2. Edlira Ibrahim Bilo
3. Violeta Gjovalin Palokaj (Perbiba)
4. Esmeralda Ded Heymann (Dedaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Ilir Meta**VENDIM****Nr. 389, datë 30.6.2021**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 389, DATË 12.6.2019, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRITERET PËR
LËSHIMIN E PASAPORTËS
DIPLOMATIKE DHE ASAJ TË
SHËRBBIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 8668, datë 23.11.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shteti”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 14, të vendimit nr. 389, datë 12.6.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët “... pasaportat përkatëse deri më datë 30 qershor 2021.” zëvendësohen me “... pasaportat e vlefshme përkatëse deri më datë 31 dhjetor 2022”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

VENDIM**Nr. 141, datë 15.6.2021**

**MBI MIRATIMIN E RREGULLORES, PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË
VLERËSIMIT DHE TË PËRZGJEDHJES
SË FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË
FUNDIT, NË SEKTORIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016, “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të energjisë elektrike”; të nenit 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.6.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 89/1 prot., datë 9.6.2021, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi “Miratimin e rregullores për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, në sektorin e energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Në nenin 87, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet se: “ERE, bazuar në kushtet e përcaktuara sipas pikës 1, të këtij neni, cakton Furnizuesin e Mundësisë së Fundit”.

- Këshilli i Ministrave, me VKM-në nr. 449, datë 15.6.2016, ka vendosur “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të energjisë elektrike”. Në seksionin III, të VKM-së nr. 449,



datë 15.6.2016, Këshilli i Ministrave ka vendosur se: “deri në përzgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, sipas këtij vendimi, ERE cakton përkohësisht furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për të kryer detyrat e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit”.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 115, datë 8.7.2016, “Mbi përcaktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të energjisë elektrike”, dhe në vijim, me vendimin nr. 96, datë 4.7.2017, mbi shtyrjen e afatit të vendimit të ERE-s nr. 115, datë 7.8.2016, “Mbi përcaktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të energjisë elektrike”, është vendosur përkohësisht OSHEE sh.a. në cilësinë e Furnizuesit të Shërbimit Universal, për të kryer detyrat e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të energjisë elektrike, nga data 1 korrik 2016, deri në përzgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit sipas VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016.

- Në rastet kur klienti nuk arrin të sigurojë furnizues në treg për shkak të pamundësisë objektive të operatorëve të sistemit, furnizimi si mundësi e fundit kryhet në të njëjtat kushte me shërbimin universal të furnizimit, sipas parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 449, datë 15.6.2016”.

- Bordi i ERE-s, me anë të vendimit nr. 131, datë 10.8.2020, vendosi: “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së Furnizuesit të Mundësisë së Fundit në sektorin e energjisë elektrike”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar dhe u njoftuan palët e interesit që brenda 20 ditëve të shprehnin opinionin e tyre me shkrim.

- Në përfundim të afateve për pritjen e komenteve të palëve të interesit rezultoi se vetëm shoqëria FTL sh.a. ka përcjellë në ERE shkresën e saj me komente e sugjerime në lidhje me këtë rregullore.

- Sugjerimet e FTL sh.a., për përshtatjen e termave dhe përkufizimeve të kësaj rregulloreje në një gjuhë më të thjeshtë dhe të qartë, janë vlerësuar të drejta dhe janë reflektuar në rregullore.

- Sugjerimet e FTL sh.a., për përfundimin nga kjo rregullore të disa nga kriterëve të përcaktuara në VKM-në nr. 449, datë 15.6.2016, nuk u vlerësuan të drejta e nuk janë pranuar.

- Sugjerimet FTL sh.a., për përthithjen e dispozitave të veçanta të kësaj rregulloreje në një dispozitë të vetme, janë pranuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së Furnizuesit të Mundësisë së Fundit në sektorin e energjisë elektrike, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E KRITERËVE TË
VLERËSIMIT DHE TË PËRZGJEDHJES SË
FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT
Miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s
nr. 141, datë 15.6.2021

Neni 1
Qëllimi

1.1 Kjo rregullore përcakton kriteret bazë të vlerësimit, si dhe procesin për përzgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit që i kërkohet të kryejë shërbimin e furnizimit, në përputhje me nenin 86, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016, “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të energjisë elektrike”.

1.2 Kjo rregullore përcakton:

a. procesin e përzgjedhjes së Furnizuesit të Mundësisë së Fundit;

b. detyrimet në lidhje me kushtet që kualifikojnë një të licencuar për të aplikuar dhe për t’u emëruar si Furnizuesi i Mundësisë së Fundit;

c. kriteret e vlerësimit që do të përdoren për përzgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit pas një procesi konkurrimi;



d. të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e aplikuesit si Furnizues i Mundësisë së Fundit.

Neni 2 Përkufizime

Shprehjet që përdoren në këtë rregullore kanë kuptimet e mëposhtme:

2.1 Enti Rregullator i Energjisë (ERE) - është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë, i cili funksionon në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar;

2.2 Furnizimi i Mundësisë së Fundit - furnizimi i përkohshëm i klientëve fundorë, në kushtet e parashikuara në ligjin për sektorin e energjisë elektrike, të cilëve u sigurohet furnizim i përkohshëm brenda kufijve të përcaktuar me këtë ligj;

2.3 Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) - është një furnizues i caktuar në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, i cili ofron për një periudhë të kufizuar kohe shërbimin e furnizimit në kushte të rregulluara ndaj klientëve, të cilët nuk kanë mundur të kontraktojnë vetë një furnizues ose kanë humbur furnizuesin e tyre;

2.4 Shërbim Universal i Furnizimit - është një shërbim publik për furnizimin e klientëve fundorë, i cili siguron të drejtën e tyre për t’u furnizuar me energji elektrike të një cilësie të caktuar, brenda gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë, me çmime të rregulluara, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente dhe jo diskriminuese;

2.5 Konkurs - do të thotë tërësia e procedurave në vijim të një ftese të shpallur publikisht për aplikime për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit, të organizuara sipas kushteve të përcaktuara në procedurën e përzgjedhjes së Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.

2.6 Çdo përkufizim ose term tjetër i përdorur në këtë rregullore, ka të njëjtin kuptim me atë të përdorur në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016, “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të energjisë elektrike”.

2.7 Ditë - në kuptim të kësaj rregulloreje, në çdo rast do të kuptohen ditët kalendarike.

Neni 3 Furnizuesi i mundësisë së fundit (FMF)

3.1 Një Furnizues i Mundësisë së Fundit, siç përcaktohet në paragrafin 1, në pikën 8, të kushteve dhe procedurave për përcaktimin e këtij furnizuesi, në VKM-në nr. 449/2016, konsiderohet si personi i caktuar për të siguruar furnizimin e mundësisë së fundit me energji elektrike për konsumatorët familjarë dhe konsumatorët e vegjël jofamiljarë, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 86, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në territorin e Republikës së Shqipërisë, për një periudhë 3-vjeçare, nga momenti i përzgjedhjes.

3.2 Në paragrafin 1, të nenit 86, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë”, të ndryshuar, si dhe në VKM-në nr. 449, datë 15.6.2016, Furnizuesi i Mundësisë së Fundit ngarkohet me detyrimin për të furnizuar të gjithë klientët të cilët mbeten pa furnizues, për një periudhë të kufizuar 60 (gjashtëdhjetë) ditore, apo klientët që dalin për herë të parë në treg të liberalizuar për një periudhë 2-vjeçare, në rastet e mëposhtme:

a. furnizuesi i mëparshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi, është në paafësi financiare ose është në procedurë falimentimi, ose;

b. licenca e furnizimit të furnizuesit të mëparshëm i është pezulluar ose hequr përkohësisht;

c. klienti nuk ka arritur të gjejë një furnizues në treg.

3.3 Do të ketë një Furnizues të Mundësisë së Fundit për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3.4 Furnizuesi i Mundësisë së Fundit blen dhe shet energji elektrike me çmime të përcaktuara sipas “Metodologjisë së përcaktimit çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendim të ERE-s.

Neni 4 Hapja e konkurrimit

4.1 Konkursi shpallet dhe organizohet, nga Komisioni i përbërë nga kryetari i Komisionit dhe 4 anëtarë të caktuar me urdhrin e kryetarit të ERE-s.



4.2 Furnizuesi i Mundësisë së Fundit i propozuar nga Komisioni miratohet me vendim të Bordit.

4.3 Anëtarët e Komisionit do të veprojnë në mënyrë transparente, të paanshme dhe jodiskriminuese. Në rastet kur një anëtar i Komisionit ka ndonjë marrëdhënie private ose profesionale me një aplikant të njohur ose të mundshëm, ose nuk mund të sigurojë pavarësinë e tij/saj nga ndonjë aplikant i mundshëm, ai ose ajo do t'i sigurojë kryetarit të ERE-s një shpjegim me shkrim dhe do të tërhiqet nga aktivitetet e Komisionit.

4.4 ERE, bazuar në kushtet e përcaktuara sipas pikës 1, të nenit 87, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, cakton Furnizuesin e Mundësisë së Fundit.

4.5 Furnizuesi i Mundësisë së Fundit emërohet për të ushtruar funksionet si Furnizues i Mundësisë së Fundit për një periudhë prej tre (3) vjet, në përputhje me VKM-në nr. 449, datë 15.6.2016, "Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të energjisë elektrike".

4.6 Në rast se në përfundim të afatit të ushtrimit të funksioneve të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, nga i licencuari i zgjedhur si i tillë, nuk është përzgjedhur furnizuesi për periudhën pasardhëse, ERE cakton një furnizues që të ushtrojë përkohësisht funksionin e FMF-së, për një periudhë jo më të gjatë se gjashtë (6) muaj, brenda së cilës do të zhvillohet një proces i ri përzgjedhjeje. Në rast se konkurrimi dështon, për shkak se nuk ka kandidatë konkurrues apo konkurrimi nuk jep rezultat, ERE, duke marrë në konsideratë elementet e sigurisë, ekonomike, teknike dhe eksperiencën në aktivitetin e furnizimit, cakton FMF të përkohshëm me një vendim të veçantë, duke përcaktuar të gjitha termat dhe kushtet për vendosjen e detyrimeve të shërbimit publik. Të drejtat dhe detyrimet mes furnizuesit të përkohshëm të zgjedhur si FMF nga ERE dhe FMF-së në fuqi, sa i përket detyrimeve të pashlyera nga klientët që kanë përfutur këtë shërbim, janë ato të parashikuara në rregulloren për ndryshimin e Furnizuesit të Energjisë Elektrike.

4.7 Jo më vonë se 4 muaj para përfundimit të afatit të ushtrimit të funksioneve si FMF të licencuarit të caktuar si FMF, ERE do të zhvillojë një procedurë të re konkurrimi.

4.8 Procedura e konkurritit e parashikuar në këtë nen, do të jetë në formën e një ftese për konkurrim që i drejtohet të gjithë të licencuarve për ushtrimin e aktivitetit të furnizimit.

4.9 Ftesa për konkurrim që do të përgatitet nga Komisioni do të përmbajë këto informacione dhe kërkesa për dokumentacion:

a. datën dhe kohën kur do të zhvillohet procedura e konkurritit, si dhe procesi për paraqitjen e aplikimeve, si dhe oraret dhe datat e tjera të rëndësishme për procesin e konkurritit;

b. shërbimet që kërkohet të kryejë një kandidat për FMF, përfshirë fillimin e shërbimit dhe kushtet e tij;

c. kriteret kualifikuese që duhet të plotësojnë subjektet që kanë të drejtë të jenë FMF;

d. kriteret që ERE do të zbatojë në vlerësimin e ofertës më të mirë, të cilat do të bëhen publike në faqen zyrtare të ERE-s.

4.10 Komisioni do t'i informojë aplikantët për vendimin e tij për refuzimin e aplikimit për përzgjedhjen si FMF, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e paraqitjes së aplikimeve. Jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga përzgjedhja e ofertuesve që kualifikohen për të vijuar procesin, Komisioni do të vijojë me renditjen e kandidatëve sipas pikëzimit nga më i larti te më i ulëti dhe i propozon Bordit përzgjedhjen e kandidatit të vlerësuar me më shumë pikë.

4.11 Bordi i ERE-s, brenda 5 ditëve nga paraqitja e propozimit nga Komisioni shprehet në lidhje me propozimin e Komisionit për përcaktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.

4.12 Vendimi i përzgjedhjes së FMF-së përmban një informacion të përgjithshëm mbi kriteret e vlerësimit të FMF-së së përzgjedhur, si dhe mbi kushtet e shërbimit të Furnizimit të Mundësisë së Fundit.

4.13 Nëse një aplikues nuk është i kënaqur me vendimin e ERE-s, për përzgjedhjen e FMF-së dhe/ose skualifikimin e tij, ka të drejtën e rishikimit dhe ankimit sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Fazat e konkurritit

5.1 Konkursi i cili do të shpallet nga Komisioni, i ngritur me urdhër të kryetarit të ERE-s, do të përfshijë fazat e mëposhtme:

a. shpallja e ftesës për konkursin e përzgjedhjes së FMF-së;



b. dorëzimi i dokumenteve të konkursit;
c. një vlerësim i dokumenteve të konkursit nga Komisioni,

d. shpallja e ofertuesve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar

5.2 Kushtet dhe afatet e secilës fazë të konkursit, janë ato të parashikuara në këtë rregullore.

Neni 6

Shpallja e konkursit

6.1 Procedura e konkursit hapet me shpalljen e ftesës për pjesëmarrje nga Komisioni i ngritur për këtë qëllim.

6.2 Në çdo rast ftesa për konkurs do të përgatitet nga Komisioni, sipas aneksit bashkëlidhur dhe do të publikohet në faqen e internetit të ERE-s, si dhe mediat kombëtare.

6.3 Ftesa për Konkurs duhet të përmbajë si më poshtë:

a. bazën ligjore dhe kushtet e konkursit;

b. hapat ligjore për procedurën e kualifikimit, përzgjedhjes dhe të përcaktimit nga komisioni i konkursit;

c. afatet e paraqitjes së dokumenteve të konkursit;

d. fazat dhe afatet e procedurës së konkursit sipas nenit 5.1;

e. dokumentacionin që duhet të dorëzohet nga aplikanti, sipas pikës 1, germa e nenit 8;

f. kriteret e vlerësimit dhe të përzgjedhjes sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje;

g. adresën për paraqitjen e dokumenteve të konkursit; dhe

h. detajet e kontaktit dhe orari i punës së personit të ngarkuar me detyrën e dhënies së informacioneve që lidhen me konkursin.

6.4 Dokumentet e referencës, të përgatitura nga Komisioni, i bashkëngjiten ftesës për konkurs dhe do të paraqesin informacion të detajuar për konkursin dhe aktivitetin që duhet të garantoj Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

Neni 7

Dorëzimi i dokumenteve të konkursit

7.1 Të gjitha dokumentet e konkursit të paraqitura në emër të një të licencuari nënshkruhen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar.

7.2 Në rastet kur është e pamundur të sigurohen origjinalet e dokumenteve të kërkuara të konkursit, aplikanti duhet të sigurojë kopjet e noterizuara.

7.3 Të gjitha dokumentet e konkursit duhet të dorëzohen në gjuhën shqipe. Dokumentet e lëshuara në vendet e tjera do të vërtetohen nga një vule apostile dhe do të dorëzohen së bashku me përkthimin e tyre në gjuhën shqipe.

7.4 Afati i paraqitjes së dokumenteve të konkursit (dita dhe ora) përcaktohet nga Komisioni i Konkursit dhe specifikohet në ftesën për konkurs, duke llogaritur një afat prej 15 ditë kalendarike pas datës së shpalljes së ftesës për konkurs.

7.5 Në çdo kohë, përpara afatit të fundit për dorëzimin e dokumenteve të konkursit, çdo aplikant i mundshëm mund të kërkojë me shkrim personit të përcaktuar në ftesën për konkurs për informacion shtesë mbi konkursin. Personi i përcaktuar për dhënien e informacionit shtesë të sigurojë dhënien e informacionit jo më vonë se afati përfundimtar i përcaktuar në pikën 4, të këtij neni. Informacioni para së të dërgohet, konfirmohet nga Komisioni. Kërkesat për informacion dhe informacionet e dhëna në përgjigje do të publikohen në faqen zyrtare të ERE-s.

7.6 Mënyra e dorëzimit të dokumenteve të konkursit do të jetë në formën e shpallur në ftesën për konkurs, brenda afatit të përcaktuar në thirrjen për konkurs. Dorëzimi i vonuar i dokumenteve të konkursit përbën kusht për skualifikim të aplikantit.

Neni 8

Dokumentacioni i aplikimit

8.1 Aplikuesi, për t'u caktuar si Furnizues i Mundësisë së Fundit, në përputhje dhe me VKM-në nr. 449/2016, duhet të dorëzojë dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a. ekstraktin e regjistrimit tregtar, nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, të lëshuar jo më vonë se 3 muajt e fundit;

b. kopje të licencës për furnizimin me energji elektrike, për të ushtruar aktivitetin në Republikën e Shqipërisë, të vlefshme për të paktën 3 vitet në vijim;

c. përshkrimin e kapaciteteve teknike, organizative, profesionale dhe financiare të shoqërisë përfshirë pasqyrat financiare të audituara të 2 viteve të fundit;



d. dëshmi të nevojshme (kontrata apo dëshmi të transaksioneve) që shoqëria shet, blen dhe furnizon energji elektrike nëpërmjet transaksioneve përkatëse të tri viteve të fundit;

e. dokumente, që vërtetojnë se personi juridik i ka plotësuar detyrimet fiskale dhe të sigurimeve shoqërore, lëshuar nga administrata tatimore jo më herët se 3 muaj nga momenti i dorëzimit;

f. dokumentin që vërteton se personi juridik nuk është dënuar me vendim të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e shoqërisë, lëshuar nga institucionet përgjegjëse;

g. dokumentin që vërteton se drejtuesit e shoqërisë apo përfaqësuesi ligjor i personit juridik nuk ndodhet në ndjekje penale, lëshuar nga prokuroria;

h. informacion të detajuar për aktivitetin e tij, bazuar në kërkesat e përgjithshme, të specifikuara në këtë rregullore dhe veçanërisht:

- eksperiencën e tij të mëparshme në aktivitetin e furnizimit dhe kategorinë e klientëve të furnizuar;

- datën kur është i gatshëm për fillimin e ushtrimit të funksioneve të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit;

i. dëshmi të sigurimit të ofertës.

8.2 Aplikuesi do të dorëzojë në ERE një kopje të sigurimit të ofertës. Dëshmia e sigurimit të ofertës do jetë e barabartë me vlerën 1.500.000 lekë, të siguruar në një nga institucionet financiare që mund të ofrojnë këtë shërbim, me një afat vlefshmërie jo më pak se kohëzgjatja e procedurës për shpalljen e fituesit të zgjedhur sipas këtyre rregullave.

Neni 9

Kriteret për zgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit

9.1 Konkursi për emërimin e FMF-së do të konsiderohet i vlefshëm nëse jo më pak se dy (2) konkurrentë kanë përmbushur kriteret e pranimit.

9.2 I licencuari që ka të drejtë të jetë një FMF, duhet të jetë në gjendje të sigurojë prova për sa në vijim:

- a. resurset administrative, teknologjinë e informacionit, sistemet e faturimit dhe burimet njerëzore me aftësinë për të transferuar një numër të madh të të dhënave të klientëve me përgjegjësi, me saktësi dhe në kohën e duhur, si dhe eksperiencat e mëparshme në fushën e furnizimit;

- b. treguesit operacionalë dhe financiarë, të aftë të identifikojnë se cilëve klientë u shërbehen nën kushtet e FMF-së, dhe cilëve klientë në kushtet e një furnizuesi të energjisë;

- c. kapacitetin financiar për të furnizuar me energji elektrike të mjaftueshme shtesë, për të përmbushur kërkesat e klientëve që furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit, pa cenuar shërbimin ndaj klientëve të tjerë me të cilët ka nënshkruar kontratë furnizimi.

9.3 I licencuari që dëshiron të jetë një FMF duhet të garantojë dhe dokumentojë që:

Mund t'u shërbejë klientëve në kushtet e Furnizimit të Mundësisë së Fundit, duke garantuar një shërbim të vazhdueshëm, për një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditësh ose prej 2 vjetësh, për klientët që kanë dalë për herë të parë në treg të liberalizuar. Për këtë qëllim depoziton në aplikim kontratat e lidhura gjatë 3 viteve të fundit të sigurimit të shërbimit të furnizimit.

9.4 I licencuari i cili aplikon për FMF duhet të dokumentojë eksperiencën në fushën e furnizimit me energji elektrike nëpërmjet depozitimit të minimumit prej 5 kontrata furnizimi, të lidhura dhe të realizuara me sukses të paktën në një vit.

9.5 Të gjithë furnizuesit që paraqesin aplikim të pranuar në afat ose para afatit të parashikuar në ftesën për konkurs, e që demonstrojnë respektimin e kërkesave të përcaktuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje dhe janë në përputhje me specifikimet e përcaktuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje, do të konsiderohen në përputhje me kushtet e konkurrencës dhe do të kenë të drejtë të ofrojnë shërbimin e FMF-së nëse vlerësohen dhe shpallen fitues nga Komisioni. ERE njofton aplikantët e kualifikuar, si dhe publikon në faqen zyrtare të saj, listën e aplikantëve të kualifikuar për konkurrim.

9.6 Aplikimi i paraqitur që nuk konsiderohet në përputhje me paragrafin 1 ose pranohet më vonë nga Komisioni, do të refuzohet/s'kualifikohet, dhe aplikuesi do të konsiderohet i papërshtatshëm për të qenë FMF, si dhe gëzon të drejtën të informohet për këtë nga ERE duke dhënë arsyet për refuzimin e aplikimit.

9.7 Jo më vonë se 5 dite nga marrja dijeni për skualifikimin, i licencuari i skualifikuar ka të drejtë të ankimojë këtë vendim të ERE-s.

9.8 Në çdo rast që pranë Komisionit të vlerësimit paraqitet një kërkesë për rishikim të skualifikimit, Komisioni ia bën me dije kryetarit



dhe për shqyrtimin e kësaj kërkesë me urdhër të Kryetarit ngrihet një grup pune i përbërë nga 3 anëtarë të ndryshëm nga ata të Komisionit të vlerësimit, të cilët shqyrtojnë ankesën brenda 5 ditëve pune, dhe informacionin e paraqesin në bord për shqyrtim.

Neni 10

Vlerësimi i ofertuesve të kualifikuar

10.1 Komisioni i vlerësimit i ngritur nga ERE, do të vlerësojë furnizuesit që janë kualifikuar nga Komisioni në çdo rast bazuar në:

a. aftësitë e furnizuesit, në lidhje me përmbushjen e detyrimit të furnizimit si Furnizues i Mundësisë së Fundit duke marrë në konsideratë eksperiencën e furnizuesit në treg dhe referencat përkatëse, kontrata furnizimi të realizuara me sukses, si dhe platformën për menaxhimin e informacionit, lëshimin e faturave dhe arkëtimin e tyre, si dhe informimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me klientin;

b. propozimin e aplikantit në lidhje me alternativat për kushtet e pagesave;

c. kostot administrative me të cilat ofertuesi do të sigurojë shërbimin e FMF-së.

10.2 Secilit nga kriteret më sipër i korrespondojnë një numër pikësh si vijon:

a. aftësia e furnizuesit sipas germës “A”, maksimumi 50 pikë,

b. alternativat për kushtet e pagesës të propozuara nga furnizuesi, sipas germës “B”, maksimumi 20 pikë; dhe

c. kostot administrative sipas germës “C”, maksimumi 30 pikë për ofertën me kostot më të ulëta.

10.3 Komisioni do të zgjedhë midis furnizuesve që kualifikohen për konkurrim, furnizuesin që ka ofertën më të mirë, duke ofruar marzhin më të ulët të fitimit në krahasim me aplikuesit e tjerë.

10.4 Në kushtet e ofertave me pikë të barabarta do të vijohet me përzgjedhjen e fituesit sipas shortit të organizuar nga Komisioni mbi bazën e rregullave bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

Neni 11

Përcaktimi i furnizuesit të mundësisë së fundit

11.1 Bordi i ERE-s, pas paraqitjes së relacionit të argumentimit ligjor, ekonomik, teknik nga

Komisioni, merr vendimin për caktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.

11.2 Nëse zbulon ndonjë shkelje të kërkesave, që lidhen me procesin dhe kriteret e përzgjedhjes, Bordi mund të refuzojë kërkesën e Komisionit për miratim të Furnizuesit të zgjedhur të Mundësisë së Fundit. Komisioni duhet të përzgjedhë dhe të ripropozojë për miratim në Bord, përcaktimin si FMF të një nga aplikuesit që plotëson kriteret e përzgjedhjes të parashikuara në këtë rregullore.

11.3 Bazuar në vendimin e miratuar nga ERE, Furnizuesi i zgjedhur i Mundësisë së Fundit caktohet të sigurojë furnizimin me energji elektrike të mundësisë së fundit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

11.4 Vendimi për caktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit publikohet në Fletoren Zyrtare dhe në faqen e internetit të ERE-s dhe furnizuesit të zgjedhur. Vendimi do t'i dërgohet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

11.5 Furnizuesi i caktuar i Mundësisë së Fundit publikon informacionin e nevojshëm për furnizimin me energji elektrike të mundësisë së fundit në faqen e tij të internetit dhe informon operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes. ERE do të specifikojë përmbajtjen e botimit të njoftimit.

11.6 ERE do të monitorojë dhe mbikëqyrë veprimtarinë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit në përputhje me ligjin në fuqi. Sa më sipër, përfshin por nuk kufizohet, edhe në përcjelljen e çdo dokumenti që i nënshtrohet rinovimit, të përcjellë për qëllime të aplikimit për përzgjedhjen si FMF.

Neni 12

Të drejtat dhe detyrimet e FMF-së dhe klientëve Që furnizohen nga FMF-ja

12.1 Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të informojë ERE-në, pa asnjë vonesë, për ndonjë shqetësim në funksionimin e saj, pamundësinë ose rrezikun e pamundësisë për të kryer Furnizimin e Mundësisë së Fundit.

12.2 Të drejtat dhe detyrimet e të licencuarit të përzgjedhur si Furnizues i Mundësisë së Fundit dhe klientëve që përfitojnë këtë shërbim janë ato që parashikohen në “Rregullat për kushtet e shërbimit të furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, dhe kushtet kontraktore të furnizimit me energji elektrike” të miratuara nga ERE.



Neni 13

Dispozitat përfundimtare

13.1 ERE ka të drejtë të ndryshojë ose modifikojë çdo dispozitë të kësaj rregulloreje.

13.2 Procedurat për ndryshimin ose modifikimin e kësaj rregulloreje do të jenë të njëjta me ato të miratimit.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Aneks 1**FTESË**

**PËR PJESËMARRJE NË KONKURSION
PËR PËRZGJEDHJEN E FURNIZUESIT TË
MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR NJË
PERIUDHË 3-VJEÇARE**

1. Ky konkurs zhvillohet në përputhje me nenin 86, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016, “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të energjisë elektrike”, si dhe “Rregullores për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së Furnizuesit të Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 141, datë 15.6.2021.

2. Konkursi shpallet dhe organizohet, nga Komisioni i përbërë nga _____

3. Dokumentet që duhet të paraqesë çdo aplikues:

j. ekstraktin e regjistrimit tregtar, nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit të lëshuar jo më vonë se 3 muajt e fundit;

k. kopje të licencës për furnizimin me energji elektrike për të ushtruar aktivitetin në Republikën e Shqipërisë, të vlefshme për të paktën 3 vitet në vijim;

l. përshkrimin e kapaciteteve teknike, organizative, profesionale dhe financiare të shoqërisë përfshirë pasqyrat financiare të audituara të 3 viteve të fundit;

m. dëshmi të nevojshme (kontrata apo dëshmi të transaksioneve) që shoqëria shet, blen dhe

furnizon energji elektrike nëpërmjet transaksioneve përkatëse të paktën të vitit të fundit;

n. dokumente, që vërtetojnë se personi juridik i ka plotësuar detyrimet fiskale dhe të sigurimeve shoqërore, lëshuar nga administrata tatimore jo më herët se 3 muaj nga momenti i dorëzimit;

o. dokumentin që vërteton se personi juridik nuk është dënuar me vendim të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e shoqërisë, lëshuar nga institucionet përgjegjëse;

p. dokumentin që vërteton se drejtuesit e shoqërisë apo përfaqësuesi ligjor i personit juridik nuk ndodhet në ndjekje penale, lëshuar nga prokuroria;

q. informacion të detajuar për aktivitetin e tij, bazuar në kërkesat e përgjithshme, të specifikuara në këtë Rregullore dhe veçanërisht:

- eksperiencën e tij të mëparshme në aktivitetin e furnizimit dhe kategorinë e klientëve të furnizuar;

- datën kur është i gatshëm për fillimin e ushtrimit të funksioneve të furnizuesit të mundësisë së fundit;

r. dëshmi të sigurimit të ofertës sipas legjislacionit në fuqi.

4. Kushtet që duhet të plotësojë aplikanti në konkurs:

1. Aplikanti duhet të jetë në gjendje të sigurojë prova për sa në vijim:

d. resurset administrative, teknologjinë e informacionit, sistemet e faturimit dhe burimet njerëzore me aftësinë për të transferuar një numër të madh të të dhënave të klientëve me përgjegjësi, me saktësi dhe në kohën e duhur;

e. treguesit operacionale dhe financiarë, të afta të identifikojnë se cilëve klientë u shërbehen nën kushtet e FMF, dhe cilëve klientë në kushtet e një furnizuesi të energjisë;

f. kapacitetin financiar për të furnizuar me energji elektrike të mjaftueshme shtesë, për të përmbushur kërkesat e klientëve që furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit, pa cenuar shërbimin ndaj klientëve të tjerë me të cilët ka nënshkruar kontratë furnizimi.

2. Të garantojë dhe dokumentojë që mund t'u shërbejë klientëve në kushtet e furnizimit të mundësisë së fundit, duke garantuar një Shërbim të vazhdueshëm periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditësh ose prej 2 vjetësh për klientët që kanë dalë për herë të parë në treg të liberalizuar. Për këtë qëllim depoziton në aplikim kontratat e lidhura



gjatë vitit të fundit të sigurimit të shërbimit të furnizimit.

5. Komisioni i Vlerësimit, do të vlerësojë furnizuesit që janë kualifikuar nga Komisioni sipas pikavarazhit më të lartë në kriteret e mëposhtme:

- aftësitë e furnizuesit, në lidhje me përmbushjen e detyrimit të furnizimit si furnizues i mundësisë së fundit, duke marrë në konsideratë eksperiencën e furnizuesit në treg dhe referencat përkatëse, kontrata furnizimi të realizuara me sukses, si dhe platformën për menaxhimin e informacionit, lëshimin e faturave dhe arkëtimin e tyre, si dhe informimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me klientin - **maksimumi 50 pikë;**

- propozimin e aplikantit në lidhje me alternativat për kushtet e pagesave - **maksimumi 20 pikë;**

- kostot administrative me të cilat ofertuesi do të sigurojë shërbimin e FMF-së - **maksimumi 30 pikë për ofertën me kostot më të ulëta.**

6. Afati i fundit për dorëzimin e ofertës është data _____

7. Afati i fundit për shpalljen e fituesit është data _____

8. Aplikimet duhet të dërgohen në adresën postare të ERE-s _____ brenda orës 16.30 të çdo dite pune, por jo më vonë se data _____.

Nëse oferta dorëzohet me postë, do të konsiderohet se është dorëzuar rregullisht brenda afatit të dorëzimit të ofertave, nëse data e shënuar në vulën postare të zarfeve, e konfirmuar me anë të njoftimit të shërbimit postar, është jo më vonë se Afati i Dorëzimit të Ofertave.

9. Jo më vonë se 5 ditë nga marrja dijeni për skualifikimin, i licencuari i skualifikuar ka të drejtë të ankimojë këtë vendim të Komisionit.

10. Për pyetje në lidhje me aplikimin adresojini në adresën email _____

Aneks 2

PROCEDURA E ORGANIZIMIT TË SHORTIT PËR SHPALLJEN E FITUESIT MIDIS KANDIDATËVE QË KANË MARRË NUMËR TË BARABARTË PIKËSH

Neni 1

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat që zbatohen për organizimin e shortit, për shpalljen fitues të kandidatëve që marrin numër të barabartë pikësh në konkursin për shpalljen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.

Neni 2

Bordi i ERE-s merr vendim për organizimin e shortit për zgjedhjen e kandidatit fitues, në rast se dy ose më shumë kandidatë kanë marrë numër të barabartë pikësh. Vendimi përmban vendin, datën dhe orën e zhvillimit të shortit.

Neni 3

Mbledhja për hedhjen e shortit organizohet në seancë publike, jo më herët se 5 ditë dhe jo më vonë se 7 ditë pas marrjes së vendimit për hedhjen e shortit.

Neni 4

Sekretari i Përgjithshëm njofton për zhvillimin e shortit i cili shpallet në faqen zyrtare të ERE-s dhe në dy media të shkruara, gjithashtu i bëhet me dije kandidatëve me pikë të barabarta.

Neni 5

1. Në datën dhe orën e caktuar për organizimin e shortit, Sekretari i Përgjithshëm i ERE-s sigurohet paraprakisht për praninë e kandidatëve përkatës dhe i fton ata të zënë vendet e caktuara.

2. Mosparaqitja e kandidatëve ose e njërit prej tyre nuk shtyn procedurat e shortit, me përjashtim të rastit kur ndonjë prej tyre paraqet shkaqe të përligjura për mosparaqitjen. Në çdo rast shtyrja bëhet vetëm një herë dhe jo më vonë se 48 orë.

3. Në një enë transparente futen aq gogla sa është edhe numri i kandidatëve pjesëmarrës në short.

4. Në secilën prej goglave futet nga një shirit letre ku në njërin prej tyre shënohet fjala “FITUES”.



5. Radha e tërheqjes së goglave sipas pikës 3, bëhet sipas rendit alfabetik të emërimit të subjektit juridik që kandidati përfaqëson.

6. Sekretari i përgjithshëm i ERE-s fton me radhë kandidatët për tërheqjen e shortit.

Neni 6

1. Kandidati që e hap goglën ia dorëzon Sekretarit të Përgjithshëm të ERE-s, i cili e lexon me zë të lartë dhe ua tregon të gjithë kandidatëve pjesëmarrës në short.

2. Pasi është tërhequr gogla me shënimin “FITUES”, Sekretari i Përgjithshëm i hap me radhë goglat e mbetura në enë, nëse ka, lexon me zë të lartë përmbajtjen e fletëve dhe ua tregon ato me radhë pjesëmarrësve në mbledhje.

Neni 7

Në përfundim të procedurës së hedhjes së shortit, Bordi i ERE-s, me vendim, shpall rezultatin e shortit duke deklaruar kandidatin fitues.

KËRKESË

Shtetasja Dylbere Sulkja kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës shpalljen të zhdukur të shtetasit Bledar Sulkja, i datëlindjes 1.2.1975, si dhe vendosjen si kujdestare të pasurisë së tij, të ëmën, shtetasen Dylbere Sulkja

KËRKUESE
Dylbere Sulkja

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 64 lekë